

Në bazë të nenit 22, 44, 50 dhe 84 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, pika 9 të nenit 13, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për Caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 070/01-130126/24 dt.03.10.2024, të aplikuesve/ investitorit “Max Company”, SH.P.K., e përfaqësuar nga pronari Fatmir Ejupi, me seli në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, dhe në emër të bashkëpronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina, për ndryshimin, plotësimin dhe korrigjimin e aktit administrativ dhe pranimin e palës në procedurë, përkatësisht shtimin e parcelës kadastrale nr.00622-2 ZK Matiçan, në aktin administrativ – Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të pronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina, dhe investitorit “Max Company” SH.P.K. e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me adresë në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, kërkesë për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, dhe lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm (“Faza -Blloku B”) -Ndërtesa/2B+P+9, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “T18”, të Planit Rregullues “Tophane” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 06.11.2024, merr këtë:

V E N D I M

NDRYSHIM-PLOTËSIMI DHE KORRIGJIMI I AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 NR.350/02-43914/23 DT.30.11.2023

I. Miratohet kërkesa 05 Nr. 070/01-130126/24 dt.03.10.2024, e aplikuesit/investitorit “Max Company” SH.P.K. e përfaqësuar nga pronari Fatmir Ejupi, me adresë në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, dhe në emër të pronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina, për ndryshimin e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 NR.350/02-43914/23 DT.30.11.2023 të lëshuar nga kjo drejtori, përkatësisht, ndryshimin /plotësimin dhe pranimin e palës në procedurë/shtimin e parcelës kadastrale me nr.00622-2 ZK Matiçan, njëkohësisht ndryshim/ plotësimi dhe korrigjimi i këtij akti administrativ bazohet edhe në rishqyrtimin e lëndës në detyrë zyrtare pas njoftimit të pranuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, lidhur me propozimin për këmbimin e pronës komunale në Lagjen Tophane, me parcelën nr.867-1 ZK Çagllavicë në pronësi private (*jashtë vijës rregulluese*), i propozuar sipas këtij akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023.

II. Ndryshohet, plotësohet dhe korrigjohet Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05NR.350/02-43914/23 DT.30.11.2023”, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të kërkuësve/pronarëve, Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina dhe investitorit “Max Company”, SH.P.K., me certifikatë të regjistrimit me numër unik identifikues 812000595 (lëshuar me datë 06.01.2023 nga ARBK, Kosovë), e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me seli në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, për caktimin e kushteve të ndërtimit, për hartimin e dokumentacionit

Faqe 1 prej 6

ndërtimor / projektin kryesor dhe lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, “Faza-Blloku B”/Ndërtesa/2B+P+9, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “T18”, të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të pjesëve dhe parcelave kadastrale me nr.6110-0, 6111-0, 7773-5, 6108-2, ZK Prishtinë, si dhe me trajtim edhe të pjesëve brenda vijës rregulluese të parcelave kadastrale me nr. 6104-1, 6112-0, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. KK Prishtinë”, dhe pjesa brenda vijës rregulluese e parcelës kadastrale me nr.7773-2, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. “Ujërat”, në këmbim me parcelën nr.867-1 (jashtë vijës rregulluese), ZK Çagllavicë, në pronësi private, sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit –“zgjdhjes urbane”.

III. Ndryshimi, plotësimi dhe korigjimi i “Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore” 05NR.350/02-43914/23 DT.30.11.2023”, ka të bëjë me shtimin e parcelës kadastrale nr.00622-2 ZK Matičan, në pronësi private të pronarit/ subjektit juridik BTP Holding SH.P.K., e cila parcelë shtrihet në hapësirë me destinim publik/ gjelbërim i planifikuar sipas Planit Rregullues “Mat 1”, me qëllim të plotësimit të sipërfaqes së nevojshme për këmbim.

Ndryshimi, plotësimi dhe korigjimi i aktit administrativ nga paragrafi II., i këtij vendimi, bëhet në pjesën tekstuale të tij, përkatësisht në preambulë, paragrafin I, III,IV, V, pika 9, IX, dhe tek pjesa e arsyetimit , dhe po ashtu i bashkëngjitet edhe pjesa grafike e parcelave të propozuara për këmbim me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Planet Rregulluese në sistem koordinativ KosovaREF0 të punuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie dhe incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami dhe atë si në vijim:

- Në preambulë:

Nga: “ ..., të aplikuesve/pronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina, dhe investitorit “Max Company”,SH.P.K. e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me adresë në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë,...”;

Bëhet: “ ..., të aplikuesve/pronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi ,Ahmed Shehu dhe BTP Holding SH.P.K. nga Prishtina, dhe investitorit “Max Company”,SH.P.K. e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me adresë në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë,...”.

-Në paragrafin I:

Nga: “ I CAKTOHEN KUSHTET NDËRTIMORE kërkuesve/pronarëve, Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina dhe investitorit “Max Company”,SH.P.K., me certifikatë të regjistrimit me numër unik identifikues 812000595 (lëshuar me datë 06.01.2023 nga ARBK, Kosovë), e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me seli në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, sipas kërkesës 05 Nr.350/02–43914/23 dt.28.02.2023, për caktimin e kushteve të ndërtimit, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor dhe lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, “Faza-Blloku B”/Ndërtesa/2B+P+9, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “T18”, të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të pjesëve dhe parcelave kadastrale me nr.6110-0, 6111-0, 7773-5, 6108-2, ZK Prishtinë, si dhe me trajtim edhe të pjesëve brenda vijës rregulluese të parcelave kadastrale me nr. 6104-1, 6112-0, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. KK Prishtinë”, dhe pjesa brenda vijës rregulluese e parcelës kadastrale me nr.7773-2, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. “Ujërat”, në këmbim me parcelën nr.867-1, ZK Çagllavicë, në pronësi private, sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit –“zgjdhjes urbane”.

Bëhet:” I CAKTOHEN KUSHTET NDËRTIMORE kërkuesve/pronarëve, Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi ,Ahmed Shehu dhe BTP Holding SH.P.K. nga Prishtina, dhe investitorit “Max Company”,SH.P.K., me certifikatë të regjistrimit me numër unik identifikues 812000595 (lëshuar me datë 06.01.2023 nga ARBK, Kosovë), e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me seli në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, sipas kërkesës 05 Nr.350/02–43914/23 dt.28.02.2023, për caktimin e kushteve të ndërtimit, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor dhe lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, “Faza-Blloku B”/Ndërtesa/2B+P+9, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “T18”, të Planit

Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të pjesëve dhe parcelave kadastrale me nr.6110-0, 6111-0, 7773-5, 6108-2, ZK Prishtinë, si dhe me trajtim edhe të pjesëve brenda vijës rregulluese të parcelave kadastrale me nr. 6104-1, 6112-0, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. KK Prishtinë”, dhe pjesa brenda vijës rregulluese e parcelës kadastrale me nr.7773-2, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. “Ujërat”, në këmbim me pjesën jashtë vijës rregulluese të parcelës nr.867-1, ZK Çagllavicë, në pronësi private, që sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, është e planifikuar si rrugë dhe gjelbërim, dhe plotësimin e sipërfaqes së nevojshme për këmbim të parcelës nr.00622-2 ZK Matiçan, në pronësi private, e përfshirë në hapësirë me destinim publik/ gjelbërim i planifikuar sipas Planit Rregullues “Mat 1”, sipas dispozitës urbane të Situacionit të parcelave të propozuara për këmbim me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Planet Rregulluese në sistem koordinativ KosovaREF0, të punuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie, incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me numër licence 12, dhe sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit –“zgjdhjes urbane”.

-Në paragrafin III shtohet përshkrimi i parcelës së shtuar:

-nr.00622-2, S=514m², ZK Matiçan, BTP Holding SH.P.K.,Kullosë e klasës 3, destinim publik/ gjelbërim i planifikuar sipas Planit Rregullues “Mat 1”;

-Në paragrafin IV.:

Nga: “...për sipërfaqet brenda vijës rregulluese, në këmbim me sipërfaqen e parcelës me nr. 867-1, ZK Çagllavicë, si në vijim:”

Bëhet: ” ..., për sipërfaqet brenda vijës rregulluese, në këmbim me sipërfaqen e parcelës me nr. 867-1, ZK Çagllavicë, me S=1549+27=1576m², (në pronësi private me destinim publik), dhe plotësimin e sipërfaqes së nevojshme për këmbim të parcelës nr.00622-2 ZK Matiçan, (në pronësi private me destinim publik), si në vijim:”

-Në paragrafin IV.pika 1):

Nga: ”..., e cila është propozuar të këmbëhet me sipërfaqe S=2020m², të parcelës kadastrale nr.867-1, ZK Çagllavicë (në pronësi private),...”

Bëhet: ” ..., e cila është propozuar të këmbëhet me sipërfaqe prej S=1549+27=1576m², të parcelës kadastrale nr.867-1, ZK Çagllavicë (në pronësi private me destinim publik-sipas Planti Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, me pjesë të saj është planifikuar si: rrugë dhe gjelbërim), dhe plotësimin e sipërfaqes së nevojshme për këmbim të parcelës nr.00622-2 ZK Matiçan (në pronësi private me destinim publik - sipas Plani Rregullues “Mat 1”- e planifikuar si gjelbërim), sipas dispozitës urbane të Situacionit të parcelave së propozuara për këmbim, me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistem koordinativ KosovaREF0 të punuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie dhe incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me numër licence 12.....”.

-Në paragrafin V., pika 10:

Nga: ” ..., duhen të këmbëhen me parcelën nr.867-1, me S=2020m², ZK Çagllavicë, (jashtë vijës rregulluese) në pronësi të Ruzhdi Ejupi, është Rrugë e planifikuar për zgjerim sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, këmbimi duhet të realizohet sipas Ligjit Nr.04L/144 dt22.11.2012,...”;

Bëhet: “..., duhen të këmbëhen me sipërfaqen prej S=1549+27=1576m², të parcelës kadastrale nr.867-1, ZK Çagllavicë (në pronësi private me destinim publik-sipas Planti Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, me pjesë të saj është planifikuar si: rrugë dhe gjelbërim), dhe plotësimin e sipërfaqes së nevojshme për këmbim të parcelës nr.00622-2 ZK Matiçan (në pronësi private me destinim publik - sipas Plani Rregullues “Mat 1”- e planifikuar si gjelbërim), i bashkëngjitet dispozita urbane e Situacionit të parcelave së propozuara për këmbim, me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistem koordinativ KosovaREF0 të punuar nga gjeodeti i kësaj

drejtorie dhe incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me numër licence 12, këmbimi duhet të realizohet sipas Ligjit Nr.04L/144 dt22.11.2012,...”;

-Në paragrafin IX.:

Nga: “KËMBIMI i pjesës së parcelës kadastrale me nr. 6104-1 me S= 350m², nr. 6112-0 me S=236m², ZK Prishtinë, në pronësi / posedim të P.SH. KK Prishtinë dhe parcela nr.7773 -0 me S=8m², ZK Prishtinë, në pronësi / posedim të P.SH. ”Ujërat”, planifikohet të këmbëhet me me parcelën nr.867, me S=2020m², ZK Çagllavicë (*jashtë vijës rregulluese*), në pronësi të Ruzhdi Ejupi , sipas manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar Festim Islami nga Prishtina, me licencë nr.12, bazuar në vlerësimin e organit kompetent dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, e miratuar nga kjo drejtori, dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar....”

Bëhet: ” KËMBIMI i pjesës së parcelës kadastrale me nr. 6104-1 me S= 350m², nr. 6112-0 me S=236m², ZK Prishtinë, në pronësi / posedim të P.SH. KK Prishtinë dhe parcela nr.7773 -0 me S=8m², ZK Prishtinë, në pronësi / posedim të P.SH. ”Ujërat”, planifikohet të këmbëhet me pjesën jashtë vijës rregulluese të parcelës nr.867-1, ZK Çagllavicë, në pronësi private, që sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, është e planifikuar si rrugë dhe gjelbërim, me sipërfaqe prej S=1549+27=1576m² dhe plotësimin e sipërfaqes së nevojshme për këmbim të parcelës nr.00622-2 ZK Matiçan, në pronësi private, e përfshirë në hapësirë me destinim publik/ gjelbërim i planifikuar sipas Planit Rregullues “Mat 1”, sipas dispozitës urbane të Situacionit të parcelave të propozuara për këmbim me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistem koordinativ KosovaREF0 të punuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie, incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me numër licence 12 dhe sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit, bazuar në vlerësimin e organit kompetent dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, e miratuar nga kjo drejtori, dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar....”.

IV. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore me 05 NR.350/02-43914/23 DT.30.11.2023, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 Nr. 070/01-130126/24 dt.03.10.2024, të parashtruar nga të aplikuesit/ investitori “Max Company”,SH.P.K., e përfaqësuar nga pronari Fatmir Ejupi, me seli në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, dhe në emër të bashkëpronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina, për ndryshimin, plotësimin dhe korrigjimin e aktit administrativ dhe pranimin e palës në procedurë, përkatësisht shtimin e parcelës kadastrale nr.00622-2 ZK Matiçan, në aktin administrativ – “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, të lëshuar nga kjo drejtori.

Bashkë me kërkesë janë prezantuar: Kopje e Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, të lëshuar nga kjo drejtori; Certifikatë e regjistrimit për biznesin Max Company SH.P.K., me numër unik identifikues 812000595; Certifikatën e njësisë kadastrale me P-71914050-00622-2, ZK Matiçan; Kopje e pavërtetuar e shkresës zyrtare e datës 27.09.2024, lëshuar nga kjo drejtori “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”;ndarje e parcelës kadastrale me nr.867-1, ZK Çagllavicë sipas koordinatave të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me numër licence 12;Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor afarist me Lrp.nr.4456/2024 Ref.nr.1484/2024 dt.02.10.2024, e redaktuar dhe punuar tek noter Valbona.Y Murtezi Bytyqi, e lidhur në mes pronarit BTP Holding SH.P.K. me numër unik identifikues 810693897, me

adresë në Vushtri,, pronar Sabri Hasani dhe investitorit “Max Company”,SH.P.K., e përfaqësuar nga pronari Fatmir Ejupi.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës kërkesën 05 Nr. 070/01-130126/24 dt.03.10.2024, për ndryshimin, plotësimin dhe korigjimin e aktit administrativ dhe pranimin e palës në procedurë, përkatësisht shtimin e parcelës kadastrale nr.00622-2 ZK Matiçan, në aktin administrativ – “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, të lëshuar nga kjo drejtori, në hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, dokumentacionit të prezantuar si dhe provave tjera, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të zonës/hapësirës ku gjendet lokacioni- Plani Rregullues “Tophane”, rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe rrethanat dhe faktet tjera për vendosje, në mënyrë kronologjike, ka konstatuar se:

-Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, ka miratuar kërkesën e pronarëve Behgjet Bllaca, Ruzhdi Ejupi dhe Ahmed Shehu nga Prishtina dhe investitorit “Max Company”,SH.P.K., me certifikatë të regjistrimit me numër unik identifikues 812000595 (lëshuar me datë 06.01.2023 nga ARBK, Kosovë), e përfaqësuar nga pronari z. Fatmir Ejupi, me seli në Rr. Halil Breznica, pn/, Gllamnik, Podujevë, për caktimin e kushteve të ndërtimit, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor dhe lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, “Faza-Blloku B”/Ndërtesa/2B+P+9, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “T18”, të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të pjesëve dhe parcelave kadastrale me nr.6110-0, 6111-0, 7773-5, 6108-2, ZK Prishtinë, si dhe me trajtim edhe të pjesëve brenda vijës rregulluese të parcelave kadastrale me nr. 6104-1, 6112-0, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. KK Prishtinë”, dhe pjesa brenda vijës rregulluese e parcelës kadastrale me nr.7773-2, ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. “Ujërat”, në këmbim me parcelën nr.867-1, ZK Çagllavicë, në pronësi private, sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit –“zgjdhjes urbane”;

-Bazuar në pikën IX.-KËMBIMI, të “Vendim për caktim të kushteve ndërtimore”, 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, është propozuar këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale me nr. 6104-1 me S=350m², nr. 6112-0 me S=236m² ZK Prishtinë, në pronësi / posedim të P.SH. KK Prishtinë dhe parcela nr.7773-0 me S=8m², ZK Prishtinë, në pronësi / posedim të P.SH. ”Ujërat”, me parcelën nr. 867-1, me S=2020m², ZK Çagllavicë (jashtë vijës rregulluese), në pronësi private, sipas manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar Festim Islami nga Prishtina, me licencë nr.12, bazuar në vlerësimin e organit kompetent dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas plani i situacionit – “zgjdhja urbane”, e miratuar nga kjo drejtori, dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Manuali i ndarjes, i përmendur në pikën e njëjtë, të vendimit për caktim të kushteve ndërtimore, dhe te pjesa e “**Shtojcë:...**”, në fund të vendimit, është harruar të bashkëngjitet;

-Drejtoria e Pronës, pas përfundimit të procedurës së vlerësimit në Ministrinë e Financave, ka proceduar për miratim këmbimin e pronës komunale, me pronën private, sipas përshkrimit më lartë, në mbledhjen e Kuvendit të Kryeqytetit, me datë 11.09.2024. Paraprakisht, Drejtoria e Planifikimit Strategjik të Komunës së Prishtinës, informon se parcela e propozuar për këmbim, me pjesë të saj, shtrihet brenda vijës rregulluese të bllokut urban “I-35”, të Tërësisë ‘I’, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë;

-Bazuar në njoftimin e pranuar, Drejtoria e Urbanizmit, pas analizimit dhe verifikimit të parcelës kadastrale, të propozuar për këmbim, në raport me bllokun urban, në të cilin shtrihet ajo parcelë, ka konstatuar se një pjesë e saj përfshihet brenda vijës rregulluese të bllokut të njëjtë, dhe se vlerësimi nga Ministria e Financave është bërë për tërë sipërfaqen e parcelës, e përfshirë brenda dhe jashtë vijës rregulluese të atij bllokut urban;

Drejtoria e Urbanizmit, duke u bazuar në konstatimet e lartshënuara, në rregullativën ligjore në fuqi, dhe me qëllim të korigjimit të vendimit të kushteve ndërtimore 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, duke vepruar në detyrë zyrtare, ka kërkuar nga aplikuesit që të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm, përkatësisht të prezantojnë: Manualin e ndarjes së parcelës kadastrale me nr. 867-1 ZK Çagllavicë, me

përcaktim të sipërfaqes së përfshirë jashtë vijës rregulluese, nga gjeodeti i licencuar; Propozimin e parcelës së re, në pronësi private, e përfshirë në hapësirë me destinim publik, për plotësim të sipërfaqes së nevojshme për këmbim, të cilat kërkesa pala i ka përmbushur.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionit të shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht neni 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, neni 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, neni 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe diskrecionin për vendosje në çështje të planifikimit dhe ndërtimit në bazë të neni 4, 21,22, 50 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dt. 21.06.2016, lidhur me plotësim dhe ndryshimin, gjegjësisht zgjerimin e aktit administrativ Vendimit të kushteve ndërtimore “05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023”, të miratuara, Drejtoria e Urbanizmit konstatoi se kërkesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin dhe konstatohet se mund të bëhet ndryshimi i aktit administrativ në tërë përmbajtjen e tekstit të aktit të ndryshuar “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr.350/02-43914/23 dt.30.11.2023, sipas përshkrimit në paragrafin III. të dispozitivit të këtij vendimi.

Bazuar në u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Shtojcë: Situacioni i parcelave kadastrale nr.867-1 ZK Çagllavicë dhe nr.00622-2 ZK Matëçan, me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues të bllokut urban “I-35”, të Tërësisë ‘I’, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë dhe të Planit Rregullues “Mat 1”- në sistemin koordinativ KASOVAREF 01, të punuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie dhe Manuali i ndarjes sipas incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me numër licence 12 të sipërfaqeve që sipërfaqeve që këmben të parcelës kadastrale në trajtim.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtoria, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI.

Ky Vendim u shtyp në 5 (pesë) kopje identike fizike dhe i dërgohet: Aplikuesit/Investitorit; kësaj Drejtorie, në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-43914/23 dt.28.02.2023, në dosje të lëndës 05 Nr. 070/01-130126/24 dt.03.10.2024, dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Kopje elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Drejtorisë së Pronës dhe Drejtorisë së Kadastrit.


**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/02-43914/23 DT. 06.11.2024**

Zyrtari,
Bahtie Uka



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi







Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 867-1

Zona kadastrale / Katastarska zona: Çagllavicë

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____


Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

PROPOZIM PËR NDARJEN E PARCELËS

Koordinatat e propozimit për ndarje

Nr.	Y	X
1	7512542.16	4720606.34
2	7512552.47	4720605.54
3	7512609.66	4720631.43
4	7512614.67	4720633.70
5	7512612.42	4720638.16
6	7512607.40	4720635.89



Rilevoi / Snimio: Festim Islami
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsorit zyrtar/ ime i prezime shërbëtor ligjor)

Nr. i licencës / Br. licence: 12

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 11.09.2024





A

40

49

